

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 25, datë 17.03.2023

“PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 48, DATË 11.11.2015, TË KËSHILLIT
BASHKIAK “PËR KRIJIMIN E TIRANA PARKING SI INSTITUCION NË VARËSI
TË BASHKISË TIRANË PËR ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT TË PARKIMIT
PUBLIK ME PAGESË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënparagrafi 1.1 shkronja “b” nenit 54, dhe nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në vijim të memos nr. 224/1 prot., datë 30.01.2023, të Tirana Parking, protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me nr. 4687, datë 02.02.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 48, datë 11.11.2015, të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë”, të ndryshuar, shkronja “d”, e pikës 1, shfuqizohet.
2. Ngarkohen Tirana Parking, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Policia Bashkiake për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO